



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr. 4 Datë 12 / 09 / 2018

“Për

Shfuqizimin e Vendimit të Këshillit të Basenit Ujor Mat Nr. 66, Datë 22/02/2017, “Për Miratimin e Lejes për Rehabilitimin e Rrjedhës së Ujit në Lumin Mat”,
Subjektit “Kleit Marvi” Sh.P.K”.

Në mbështetje të shkronjës “d”, të nenit 109, nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 12, të ligjit nr. 111/2012, datë 15.11.2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit, nr. 01, datë 13.01.2010, “Për ndalimin e përkohshëm të dhënies së lejeve të reja për shfrytëzimin e zhavorreve në shtretërit e lumenjve”, vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit nr. 01, datë 07.07.2011, “Për menaxhimin e shfrytëzimit të zhavorreve për ndërtimin e rrugëve”, me propozimin e Kryetarit, Këshilli I Basenit Ujor Mat

V E N D O S I :

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 66, datë 22.02.2017, “Për miratimin e Lejes për rehabilitimin e rrjedhës së ujit në lumin Mat”, subjektit “KLEIT MARVI” sh.p.k
2. Ngarkohet Agjensia e Basenit Ujor Mat për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gjergj PRENDI

